



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS KLINË

Numri i lëndës: 2020:083586

Datë: 12.04.2021

Numri i dokumentit: 01679922

**P.nr. 78/2020**

### **NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË-DEGA NË KLINË – Departamenti i Përgjithshëm**, me gjyqtarën Sabrije Rraci, dhe sekretaren juridike Shere Desku, në çështjen penale kundër të pandehurës V. (P.) R.-D., nga ..... Rr. „.....” hyrja 01 nr. 69, për shkak të veprës penale, „sulm ndaj personit zyrtar në kryerjen e detyrës zyrtare” nga neni 402, paragrafi.1 të KPRK-së, sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë PP/II nr. 821/2020, të datës 31.03.2021, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, në prani të Prokurorës së Shtetit Lumturije Vuqetaj, të pandehurës V. R. - D. si dhe e autorizuar Av. A. K. si dhe e dëmtuara Sh. B. me të autorizuarin Av. I. O., me datën 31.02.2021 mbajti shqyrtimin fillestar, ndërsa e shpalli me dt. 01.04.2021 në ora 10:00, ndërsa e përpiloi me datën 13.04.2021 këtë:

### **A K T G J Y K I M**

#### **E pandehura:**

V. ( R.) D., e lindur me dt....., e bija e P. dhe nënës D., e lindur në fsh. .... K. ....,ndërsa tani me banim në .....,rr. „.....” nr. 60, e martuar, nënë e një fëmijë, ka të kryer fakultetin e mjeksiaë me profesion Dr. e Stomatologjisë, i identifikuar me nr. personal të letërnjoftimit ..... shqiptare, shtetase e Republikës së Kosovës mbrohet në liri.

### **ËSHTË FAJTORE**

#### **Për shkak se:**

Me datë 06.04.2020, rreth orës 17:00, në QKMF-K. Klinë, me dashje sulmon personin zyrtar-të dëmtuarën Sh. B. , teknike medicinale pranë kësaj qendre, në atë mënyrë qe, me të dëgjuar e pandehura se ditën kritike, e dëmtuara dhe nëna e saj kishin pas një mosmarrëveshje në mes vete e të cilat punojnë në të njëjtën qendër, e pandehura me të arritur në vendin e lartëshënuar ku punon si stomatologe në shenjë revolte sulmon fizikisht të dëmtuarën e lartëshënuarën duke e shtyrë dhe kap të njëjtën me duar në pjesën e epërme të trupit, me qrast aty ndërhyjnë stafi i qendrës në fjalë.

**Me çka ka kryer vepër penale „Sulm i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare” nga neni 402, par 1 të KPRK-së.**

Andaj gjykata, duke vepruar në kuptim të nenit: 7,8,9,10,17,21,38,40,43,69,70,dhe nenit 402 par. 1 të KPRK, si dhe nenit 359,360,361,365,366,450 të KPPRK, e:

## G J Y K O N

**I.Të pandehurën: V. R. - D.**me dënim Burgu në kohëzgjatje prej 4 (katër ) muaj, i cili dënim me pëlqimin e të pandehurës iu zëvendësua:

**Më dënim me Gjobë shuma në vlerë prej 1800 (njëmijë e tetëqind) Euro**, të cilin dënim është e obliguar ta paguaj në afatin prej 30 (ditësh) nga dita kur ky aktgjykim të marrë formën e prerë nën kërrcni të përmbartimit me dhunë.

Nëse e pandehura nuk e paguan gjobën e njëjta do të shëndrrohet në dënim me burgim duke e llogaritur 20 (njëzet) Euro për një ditë.

**II. OBLIGOHET:** E pandehura qe ti paguaj shpenzimet e paushallit gjyqësor shuma në vlerë prej 20 (njëzet) Euro, si dhe 30 (tridhjetë) Euro për fondin e kompenzimit të viktimave të krimit, gjithsejt 50 (pesëdhjetë) euro, në afatin prej 30 (tridhjet) ditësh nga dita kur ky aktgjykim merr formën e prerë nën kërrcni të përmbartimit me dhunë.

**III.UDHËZOHET:** Pala e dëmtuar Sh. B. , nga ..... rr. „.....” qe kërkesën pasurore juridike ta realizoi në konest të rregullt juridiko civil.

## A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë ka ngritur Aktakuzë, me PP/Nr. 821/2020, të dt. 08.07.2020 në Gjykatën Themelore në Pejë-Dega në Klinë, kundër të pandehurës V. ( R.) D., nga ..... rr. „.....” hyrja 01.nr. 69 për shkak të kryerjes së veprës penale, „Sulni ndaj personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare”, nga neni 402, paragrafi.1 të KPRK-së. Gjykata mbajti seancën e shqyrtimit fillestar me dt. 31.03.2021, në prezenc të prokurorit të shtetit, të pandehurës, të autorizuarës së saj av. A. K., të dëmtuarës Sh. B. si dhe të autorizuarës së tij av. I. O..

Pas leximit të aktakuzës nga prokurori i shtetit, si dhe pasi që të pandehurit i është dhënë mundësia për tu deklaruar rreth fajësisë apo pafajësisë, duke u njoftuar paraprakisht nga gjykata për favorret dhe pasojat e njëjës dhe tjetrës, e pandehura pas konsultimit me të mbrojtëren e tij ka deklaruar së e pranon fajësinë për veprën penale qe i vihet në barrë. E cila është e vetëdijshme për përparësit dhe pasojat e pranimit të fajësisë.

E pandehura deklaroi mua më vjen keq për rastin qe më ka ndodhur, sepse kjo më ka kushtuar mua dhe asaj. Poashtu edhe e autorizuar e palës së pandehur av. A. K. pajtohet me pranimin e fajësisë nga e mbrojtura e saj, pasi ky pranim fajësie është bërë në mënyrë vullnetare, pas konsultimeve të mjaftueshme me mua, e njëjta e kupton natyrën dhe pasojat për pranimin e fajësisë, e njëjta kërkon qe pranimi i fajësisë të merret si rrethanë lehtësuese në matjen e dënimit.

**Prokurorja e shteti, nuk e kundërshton pranimin e fajësisë:** I cili pranim është bërë në mënyrë vullnetare dhe pa presion nga askush, dhe në konsultim paraprak me mbrojtësen e saj, i cili është në përputhje me shkresat e lëndës, me qka i propozoi gjykatës, qe pranimin e fajësisë të merr si rrethanë lehtësuese në matjen e dënimit, si rrethanë rënduese të merrë shkakun e përgjegjësisë penale,motivin e kryerjes së veprës penale, dhe rrethanat në të cilat është kryer

vepra penale. E në rastin konkret kur vepra është kryer në një institucion publik ku bartin përgjegjësi personale dhe zyrtare, dhe në prani të stafit të atij institucioni.

E dëmtuara Sh. B. ka deklaruar se kërkon ndjekje penale për të pandehurën, me këtë dakordohet, edhe i autorizuari i saj av. I. O..

Pas deklarimit të pandehurit se e pranon fajësinë, mendimit të mbrojtësit dhe prokurorit se pajtohen me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurës. Gjykata konstatoj se e pandehura e pranon fajësinë në mënyrë vullnetare, pa asnjë presion. I pandehuri është i vetëdijshëm për pasojat dhe përparësitë e pranimit të fajësisë, si dhe të gjitha kërkesat nga neni 248 par. 1 të KPPRK-se janë përmbushur. Ashtu që gjykata me aktvendim në procesverbal aprovon deklarimin për pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit.

Duke pas parasysh se gjykata, ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurës dhe ka vërtetuar se nuk ekziston asnjë rrethanë nga neni 253 par.1 pika 1.1, 1.2 dhe 1.3 të KPPRK-së, si dhe faktin se janë plotësuar kushte nga neni 248 par.1 të KPPRK-së, atëherë në këtë çështje penale nuk është zbatuar procedura e provave, por gjykata ka vazhduar me shqiptimin e dënimit konform nenit 248 par 4 të KPPRK-se.

Me faktet e ofruara si dhe pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurës është vërtetuar se e njëjta me datë 06.04.2020, rreth orës 17:00, në QKMF-K. Klinikë, me dashje sulmon personin zyrtar-të dëmtuarën Sh. B. , teknike medicinale pranë kësaj qendre, në atë mënyrë që, me të dëgjuar e pandehura se ditën kritike, e dëmtuara dhe nëna e saj kishin pas një mosmarrëveshje në mes vete e të cilat punojnë në të njëjtën qendër, e pandehura me të arritur në vendin e lartëshënuar ku punon si stomatologe në shenjë revolte sulmon fizikisht të dëmtuarën e lartëshënuarën duke e shtyrë dhe kap të njëjtën me duar në pjesën e epërme të trupit, me qrast aty ndërhyjnë stafi i qendrës në fjalë.

Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të aktgjykimit, pa dyshim rrjedh se në veprimet e të pandehurës, qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale „Sulm i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare” nga neni 402, par 1 të KPRK-së.

Sa i përket fajësisë gjykata ka gjetur se të pandehura ka ekzistuar dashja që veprën penale ta kryen në mënyrë të përshkruar si në dispozitiv të aktgjykimit pasi që e pandehura ka qenë i pakujdesshëm për veprën penale të kryer dhe e ka dëshiruar kryerjen e saj.

Gjatë procedurës penale nuk janë paraqit rrethana të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësinë penale të pandehurit, kështu që i njëjti është penalisht përgjegjës, për veprën penale me të cilën është akuzuar.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-se.

Kështu si rrethana lehtësuese për të pandehurën gjykata gjeti se e pandehura ka treguar sjellje korrekte gjatë shqyrtimit fillestar e për më tepër ka pranuar fajësinë dhe ka shpreh keqardhje për veprën që e ka kryer.

Rrethanë rënduese Gjykata gjeti shkallen e rrezikshmërisë që paraqet kjo veprë penale dhe dënueshmërinë e saj, ku për këtë veprë penale parashihet dënim me burgim prej 3 muaj deri në 3 vjet .Ndërsa si rrethanë tjetër posaqerisht rënduese gjykata ka gjetë motivin e kryerjes së kësaj veprë penale ka bërë bujë, jo vetëm në QKMF në Klinikë, por edhe më gjërë, për shkak se e pandehura punon në institucion publik (QKMF në Klinikë) së bashku me të dëmtuarën, ku e pandehura punon në pozitën e doktorreshës (stomatologe) ndërsa e dëmtuar si teknike medicinale.

Gjykata ka ardhur në përfundim se dënimi i shqiptuar ndaj të pandehurit është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale të saj. Gjykata gjithashtu është e bindur se vendimi mbi dënim do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit në pajtim me nenin 38 të KPRK-së, si dhe në pengimin e të pandehurit në kryerjen e veprave penale në të ardhmen, por ai do të ndikoj edhe si preventivë e përgjithshme për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale.

Duke u bazuar në nenin 450 par. 1 dhe 2 të KPPRK-së, gjykata ka përcaktuar paushallin gjyqësorë si në dispozitiv të aktgjykimi.

Vendimi për kompensimin e viktimave të krimit është marrë, konform nenit 39 par. 3 nënpar. 3.1 të Ligjit nr. 05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Nga arsyet e cekura më lartë dhe me zbatimin e nenit 370 të KPPRK-së është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## **GJYKATA THEMELORE NË PEJË – DEGA KLINË**

**P.nr. 78/2020, të datës 12.04.2021**

**Sekretare juridike**

**Shere Desku**

**G j y q t a r j a**

**Sabrije Rraci**

### **KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa  
në afatin prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtit,  
Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmes kësaj gjykate.